



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 29.10.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 26.10.2020, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Interlab shpk", për aktivitetin: "Furnizim me pajisje mjekësore për nevojat e kujdesit parësor shëndetësor QKMF dhe QMU" Nr. të Prok: 616 20 113 121 nxjerr:

VENDIM

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Interlab shpk" e datës 26.10.2020 .

2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë aktivitetin sipas publikimit të datës 21.10.2020 .

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar kërkesën e pretenduesit dhe lidhur me pretendimet e të njëjtit ka konstatuar si vijon:

-Se pari nuk qëndron pretendimi se ju keni dhënë sqarime të mjaftueshme dhe i plotësoni specifikat e AK-se të kërkuara në Aneksin 1 të DT.

Pozicioni 6: Autoklav B-klas 231 komplet me destilator dhe paketues të instrumentave
Autoklav është ofruar katalogu vetëm foto mungojnë specifikat.

Pozicioni 9: Tensiometër për të rritur

Mungojnë këto specifika:

Diametër 55mm

Manometri, me unazë mbrojtëse nuk e ka

Dimenzionet e tubit 50 deri 60 cm gjatësi, membrana 15 deri 25 cm gjerësi nuk e ka .

Pozicioni 10: Është kërkuar Otokop Oftalmoskop secila me dorëz te veqante ,ndersa eshte ofruar artikulli me kodin 31527 i cili është vetem me nje dorëz.

Oftalmoskopi duhet të ketë thjerrëza korrektuese prej -20 deri në +20.Të vendosura në çantë të veçantë ,ndersa ju nuk keni ofruar specifika per kete artikull.

Pozicioni 45 : Mbatjes Vaterolne

Kemi kërkuar **Dimesionet ~134 x 100 x 48 mm**

Keni ofruar 112x48x120

Pozicioni 49: Pulp tester - Mates i vitalitetit te pulpes

Specifikat mungojne

- INPUT: DC 9.0V
- OUTPUT: 80V (MAKSIMALE)
- AKTUALE: 90mA
- FUSHA E TENSIONIT: DC 6.0-10.0V
- MADHESIA: 186 * 38 * 24mm

Mungon katalogu dhe specifikat per pozicionet

:14,22,31,32,33,34,35,36,37,38,39,40,41,42-43,46.

Bazuar ne kete rrjedh se as produktet per te cilat keni ofruar katalogje nuk keni ofruar specifika si qe janë kërkuar nga Autoriteti Kontraktues dhe per ekte nuk janë kërkuar katalogjet as per produktet tjera


Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës , departamentit të prokurimit dhe njësisë së kërkesës.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi,nese ka deshmi dhe argumente lidhur me kerkesen e vet ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit